

KOSOVA GUIDE

KOSOVA GUIDE

@ Ky material është prodhuar në kuadër të Projektit " Përfshirja dixhitale për OSHC - të dhe Angazhimin e Qytetarëve në Bashkëpunimin Rajonal (DIGI-CORE), me mbështetje nga SMART Balkans dhe i zbatuar nga "Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë" Fushë-Arrëz (QSNNN), Instituti Edutask, dhe Qendra për Inovacionet Sociale "Blink 42-21". Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e "Qendrës Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë" Fushë-Arrëz (QSNNN) dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA) as të konsorciumit SMART Balkans.

Udhëzues Praktik Shërbimeve Publike Online

Përshëndetje të dashur qytetarë!

Ne e dimë se teknologjia mund të duket pak e ndërlikuar, sidomos kur nuk je mësuar me të. Por mos u shqetësoni! Ky udhëzues është krijuar për t'ju ndihmuar që të përdorni shërbimet publike online në mënyrë të thjeshtë dhe të sigurt. Qëllimi ynë është që ju të ndiheni të fuqizuar dhe të pavarur në përdorimin e teknologjisë.

Rreth portalit

Platforma e shërbimeve elektronike e-Kosova është sportel elektronik, përmes të cilit çdo person i interesuarit mund të marrë nëpërmjet internetit shërbime elektronike që ofrohen nga institucionet publike në Kosovë, duke shkurtuar distancën, rritur efikasitetin dhe shpejtësinë e marrjes së shërbimit.

eKosova është e ndërlidhur me Platformën e Interoperabilitetit (ndërveprimi), e cila është arkitektura bazë, mbi të cilën mundësohet ndërveprimi i regjistrave elektronikë të institucioneve të Kosovës.

Çfarë ofron eKosova

- Është dritarja e vetme nëpërmjet së cilës ofrohen në mënyrë elektronike shërbimet e institucioneve publike;
- Ofron shërbime publike 24/7/365;
- ofron shërbime elektronike të standardeve më të fundit të teknologjisë;
- mundësi për kryerjen e pagesave online për shërbime, nëpërmjet kartave të debitit dhe kreditit;
- ofron informacione për shërbimet elektronike lidhur me procedurën dhe dokumentet e nevojshme për marrjen e shërbimit
- është në përputhje të plotë me politikat e sigurisë kibernetike për mbrojtjen e të dhënave të përdoruesve;
- ofron mundësi komunikimi për çdo paqartësi, pyetje apo problem mbi regjistrimin, shërbimet e ofruara në eKosova, përmes forumit të platformës, postës elektronike, komenteve dhe mesazheve në rrjetet sociale.
- Lehtësi dhe Komoditet: Nuk keni më nevojë të prisni në radhë ose të shkoni në zyrat shtetërore. Gjithçka mund ta bëni nga shtëpia.

- Kursim Kohe: Shërbimet janë të disponueshme 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Kjo do të thotë që mund t'i përdorni kur ju përshtatet më shumë.

Cilat shërbime mund t'i merrni?

- Gjendja civile: certifikata, ekstrake për ju dhe anëtarët e familjes
- Aplikime të ndryshme për nxënës, student dhe mësimdhënës
- Pagesa të tatimit në pronë
- Shtesa dhe subvencione për familje
- Kryeni pagesa elektronike
- Certifikata të ndryshme personale dhe familjare
- Regjistrime në institucione arsimore
- Kërkim të punës, aplikim për formim profesional
- Aplikim për shërbime shëndetësore dhe mbrojtje sociale
- Aplikime dhe vërtetime rreth kontributeve dhe pensione
- Dokumente rreth gjendjes gjyqësore
- Certifikata, vërtetime, aplikime dhe pagesa për biznesin
- Taksat dhe tarifatat vendore
- Autorizime dhe dokumente doganore
- Leje dhe licenca
- Dokumente rreth automjetit dhe transportit
- Veprime rreth pasurive të paluejtshme
- Shërbime konsullore
- eKosova vazhdimisht pasurohet me shërbime të reja

Kush mund të përdor portalin eKosova?

- të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës;
- bizneset e regjistruara në Republikën e Kosovës;
- punonjësit e administratës publike në Active directory;
- vizitorët e platformës eKosova.

Si të filloni me e-Kosova?

1. Hapni një llogari:

Nëse nuk keni ende një llogari, mund ta krijoni lehtësisht duke ndjekur disa hapa të thjeshtë në faqen e e-Kosova.


2. Identifikohuni:

Pasi të keni llogarinë tuaj, identifikohuni për të hyrë në portal dhe për të filluar përdorimin e shërbimeve.

3. Zgjidhni shërbimin që ju nevojitet:

Pasi të jeni futur në portal, kërkoni shërbimin që ju nevojitet dhe ndiqni udhëzimet e thjeshta për të përfunduar kërkesën tuaj.

Kjo është faqja e parë që do të shfaqet, duke ju ofruar asistentin virtual për ndihmë:




Portali ofron opcionin për ndihmë për përdorimin e portalit


Zgjedhja e një opcioni për ndihmë do të hap faqen me udhëzime të detajuara.



Informata shtesë mund të gjinden duke shtypur opcionin përkatës



Këto janë grupet e shërbimeve të përfshira në portal. Ato janë të vendosura në grupe të shfaqura në këtë faqe.



Por, hapi i parë për përdorimin e portalit është hapja e llogarisë.

Regjistrimi – hapja e llogarisë

Regjistrimi i përdoruesit të ri

Kyçja e përdoruesit egzistues

Platforma e shërbimeve online

eKosova është platformë shtetërore ku shërbimet publike që gjenden në zyrat dhe sportelet fizike të institucioneve ofrohen në mënyrë elektronike.



Për të hapur llogarinë, duhet të plotësohet forma si më poshtë:

Për të hapur llogarinë, përdoruesi duhet të plotësojë formën me shënimet e tij/saj personale.

Kërkohen:

- Numri personal
- Emri
- Mbiemri
- Numri i telefonit
- Email adresa
- Fjalëkalimi (dy herë)
- Pajtimi me politikat e privatësisë

Pas kompletimit të formës, duhet të shtypet **Vazhdo**

Mirë se erdhët!

Shiko video udhëzuesin

Për të filluar procesin e regjistrimit ju duhet të plotësoni të dhënat në vazhdim:

Numri personal	Emri	Mbiemri
Numri i telefonit	Email adresa	
Vëmendje: Klikoni këtu për të pranuar kodin e sigurisë në email adresë, nëse nuk mbani numër të VALA apo të IPKO.		
Vendosni fjalëkalimin	Konfirmojeni fjalëkalimin	

Nuk jeni shtetas i Republikës së Kosovës? [Klikoni këtu](#)



Success!

CLOUDFLARE

DDOS • DNS • SSL

☐ Pajtohem me [Politikat](#) e [Privatësisë](#) dhe jap pëlqimin tim për përpunimin e të dhënave të mia personale për qëllim të regjistrimit dhe marrjen e shërbimeve

Ndërpreje

Vazhdo

Për ata që nuk janë qytetarë të Kosovës

Për shtetasit e huaj kërkohen edhe disa shënime shtesë, si vendi dhe data e lindjes, shtetësia dhe numri i pasaportës.

EN KOSOVA



Language: Shq Eng Srb

[Home](#) [Services](#) [Informations](#)

Welcome!

Watch video guide

To start the registration process, you have to fill in the data below:

Personal number	First name	Last name
Phone number	Email address	
Attention: Click here to receive the security code in the e-mail address. If you do not have a VALA or IPKO number.		
Write password	Confirm password	
Father name	Passport number	
Place of birth	Date of birth	
mm/dd/yyyy		
Select gender	Select citizenship	

This field is required

☐ I have a valid residence permit for the Republic of Kosovo



Success!

CLOUDFLARE

DDOS • DNS • SSL

☐ I accept the [Privacy Policy](#) and I give my consent for the processing of my personal data for the purpose of registration and use of services

Cancel

Continue

Gjithkujt mund t'i ndodhë të harrojë fjalëkalimin.
Si të veprohet në këtë rast?

Hapi 1

Në rast se keni harruar fjalëkalimin e llogarisë tuaj, atëherë duhet të klikoni mbi “Keni harruar fjalëkalimin? Rikrijo” për rikrijimin e fjalëkalimit të llogarisë suaj në platformën eKosova.

Hapi 2

Pasi të hapet dritarja e re, Shkruani numrin personal në fushën e kërkuar dhe shtypni butonin “Vazhdo”

Hapi 3

Zgjedhni metodën për pranimin e kodit konfirmues. Kodin konfirmues mund të e pranoni në SMS apo email adresë.

Hapi 4

Shkruani kodin e konfirmimit që e keni pranuar nëpërmjet email adresës

Hapi 5

Në rast se kalojnë dy (2) minuta dhe nuk e keni pranuar emailin apo nuk e keni përshkruar atë në fushën e kërkuar, atëherë duhet të parashtroji kërkesën për pranimin e kodit të ri duke klikuar mbi tekstin “Shtypni këtu për të kërkuar kod konfirmues të ri”

Hapi 6

Pas plotësimit të fushës së kërkuar klikoni butonin me emërtimin “Dërgo” për të vazhduar.

Hapi 7

Plotësoni fushat Fjalëkalimi i ri dhe Konfirmimi i fjalëkalimit të ri dhe klikoni ne butonin “Vazhdo”

Hapi 8

Nëse rikrijimi i fjalëkalimit ka përfunduar me sukses do të dërgoheni automatikisht në faqen për identifikim së bashku me mesazhin “Fjalëkalimi është rikrijuar me sukses”.

Kyçu në llogarinë tuaj

Numri personal

xxxxxxxxxxxxxxxxxx

Fjalëkalimi



☐ Më mbaj në mend



Success!



Hyr

Keni harruar fjalëkalimin?

Rikrijo fjalëkalimin

Nuk jeni të regjistruar?

Regjistrohu

Mënyrat tjera për identifikim



Si të mirren shërbimet e ndryshme në portal?

Shembull:
Gjendja civile -
Certifikata e lindjes



> Kryesore > Shërbime > Informata  

Kërko shërbimin  Shiko

Platforma e shërbimeve online

eKosova është platformë shtetërore ku shërbimet publike që gjenden në zyr sportelet fizike të institucioneve ofrohen në mënyrë elektronike.


Zgjedhet së pari grupi 'Gjendja civile'

Sporteli virtual

☐ Për qytetarë ☐ Për biznese ☐ Shërbimet me pagesë

Kërko shërbimin

Shërbimet



Mandej zgjidhet dokumenti i dëshiruar për shkarkim. Nuk ka nevojë për identifikim, portali ka ruajtur identitein e përdoruesit i cili ka hapur aplikacionin.



> Kryesore > **Shërbime** > Informata   Dugagjin Sahatqija

Gjendja civile

☐ Për qytetarë ☐ Për biznese ☐ Shërbimet me pagesë ☒ Të gjitha shërbimet

Kërko



Shkarko "Certifikatën e lindjes"

Raporto problem



Shkarko "Ekstraktin"

Raporto problem



Shkarko "Certifikatën e martesës"

Raporto problem



Shembull: Arsimi - Aplikimi për tekste dhe materiale shkollore

Te shërbimet e arsimit
zgjedhim aplikimin për
tekste dhe materiale
shkollore.



> Kryesore > Shërbime > Informata  

Arsimi

☐ Për qytetarë ☐ Për biznese ☐ Shërbimet me pagesë ☒ Të gjitha shërbimet

Kërko 



APLIKIM - Tekste dhe materiale shkollore (Klasët 1 deri 5)

Raporto problem



APLIKIM - Tekste dhe materiale shkollore (Klasët 6 deri 9)

Raporto problem



Aplikimi për licensë të karrierës në mesimdhënie

Raporto problem



Për të aplikuar, duhet
të plotësohet forma:

APLIKIM - Tekste dhe materiale shkollore (Klasët 6 deri 9)

Të dhënat e prindit/kujdestarit/ves ligjor/e

Numri personal	Emri	Mbiemri	Email
1001475517	Dugagjin	Sahatqija	dugagjin@live.com
Komuna	Numri i telefonit	Nacionaliteti	
Prishtinë	44117033	Zgjedhja e opses	

Numri i xhirologarisë bankare

Shkruaj këtu...

Vëmendje: Shënimi i kësaj forme duhet të jetë në emër të aplikuesit dhe të jetë i saktë dhe të vërtetë. Nëse aplikuesi nuk ka numër të kësaj forme, duhet të shkruajë "Nuk ka".

Të dhënat e firmijës

☐ Alikoj në rolin e prindit ☐ Alikoj në rolin e kujdestarit ligjor

DEKLARATË MBI PËRGJEGJËSITË

Deklaroj se jam prind/kujdestar ligjor i nënës/ve. Unë konfirmoj që të gjitha informacionet e paraqitura në këtë aplikim për subvencionin për tekste shkollore dhe material shkollor janë të sakta dhe të vërteta.

Deklaroj dhe pajtohem që:

1. Nënës/ve vijojnë mësimin brenda sistemit arsimor të Republikës së Kosovës.
2. Në bazë të kësaj, plotësojnë kriteret për të përfituar subvencion për tekste dhe materiale shkollore.
3. Të dhënat e dhëna nga unë në këtë aplikim janë të sakta dhe të vërteta.
4. Jam i vetëdijshëm se qdo deklarim i rremë për klasën ose shkollën mund të rezultojë në pasojë ligjore për mua, përfshirë kthimin e subvencioneve të përfituara dhe ndjekjen penale në përputhje me ligjin në fuqi.

Duke klikuar "Aprovoj", unë konfirmoj se kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate dhe pajtohem me të gjitha kushtet e mësipër

☐ Aprovoj

Apliko

Shembull:
Tatimet – Tatimi në pronë

Për të marrë dhe paguar faturën e tatimit në pronë, së pari zgjedhim opcionin 'Tatimet'



> Kryesore > Shërbime > Informata Dugagjin Sahatija

Tatimet

☐ Për qytetarë ☐ Për biznese ☐ Shërbimet me pagesë ☒ Të gjitha shërbimet

Kërko



Fatura e tatimit të pronës individuale

[Raporto problem](#)



Fatura e tatimit të pronës për persona të tjerë

[Raporto problem](#)



Zgjedhet opsi
përkatës, fatura për
veten apo për persona
tjerë.

Fatura e tatimit të pronës individuale

Lista e faturave sipas komunave

Taksapaguesi	Komuna	Për pagesë	Parapaguar	UNIREF
9823905334	Prishtinë	0,00 €	0,00 €	PRB2K3354304320K

[Paguj](#)

Totali për të gjitha faturat është: 0,00 €

[Fatura](#)

Dhe mund të vazhdohet
me pagesë. Për pagesë
do të ju duhet UNIREF.

Zgjedhni shumën e pagesës

☒ Përcakto shumën

0.00 €

[Vazhdo](#)

[Mbyll](#)

Shembull: Policia – PAGESA e gjobës

Për pagesën e gjobës nga policia, mund ta bëjmë kërkimin e të gjitha gjobave, apo duke përdorë numrin e references.

Vëreni se këtu mund të bëhet edhe aplikimi për të marrë vërtetimin e të kaluarës kriminale.

Poashtu, për të interesuarit, është e mundur të aplikojnë për polic të ri.

Po vazhdojme me shembullin e kërkimit të gjobës sipas references.

Në vazhdim kërkohet gjoba me numër të references dhe vazhdohet me pagesën.



[> Kryesore](#) [> Shërbime](#) [> Informata](#)  [Dugagjin Sahatqija](#)

Policia

☐ Për qytetarë ☐ Për biznese ☐ Shërbimet me pagesë ☒ Të gjitha shërbimet

Kërko

 Kërkimi i gjobave individuale

Raporto problem

 Kërkimi i gjobave sipas referencës

Raporto problem

 Vërtetimi i të kaluarës kriminale

Raporto problem

 Aplikimi për Polic të ri

Raporto problem



[> Kryesore](#) [> Shërbime](#) [> Informata](#)  [Dugagjin Sahatqija](#)

Kërkimi i gjobave sipas referencës

Referenca

Shkruaj këtu...

Kërko

Shembull: Komunalitë – Pagesa e energjisë elektrike

Shumë shërbime komunale mund të paguhen prej portalit.

Zgjedhim opcionin e pagesës së faturës së energjisë elektrike.

Në vazhdim kërkohet gjoba me numër të references dhe vazhdohet me pagesën.

Prej këtu mund të zgjedhim të shikojmë faturën apo ta paguajmë.

shikojmë

paguajmë

Shembull: Gjyqësori – Monitorimi i statusit të lëndëve në gjykatë

Portali ofron
mundësinë e lidhjes
me portalin e Këshillit
Gjyqësor të Kosovës
për të marrë disa
shërbime, që shihen në
figurën djathtas.

eKOSOVA > Kryesore > Shërbime > Informata > > [Dëgjoni Sahatçja](#)

Gjyqësori

☐ Për qytetarë ☐ Për biznesë ☐ Shërbimet me pagesë ☒ Të gjitha shërbimet

Kërko



Mekanizmi për përcjelljen e statusit të lëndëve individuale në Gjykatë - Është një mjet digital që lejon qasjen online në informacione për lëndë individuale gjyqësore. Ky mekanizëm përcjellës është i qasshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës përmes një procedurë të verifikuar të vërtetimit përmes platformës eKosova. Pas verifikimit të suksesshëm përmes eKosova, sistemi do të kontrollojë nëse individi është i përfshirë në të paktën një rast ligjor në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Lëndëve (SMIL). Nëse individi nuk është i përfshirë në një çështje ligjore, ai nuk do të mund të përdorë sistemin.

Platforma e të Dhënave të hapura - i ofron publikut të gjerë dhe çdo përdoruesi të internetit qasje në statistikat gjyqësore që kanë të bëjnë me punën e gjykatave dhe gjyqtarëve në Kosovë. Kjo platformë është një mekanizëm digital që u mundëson përdoruesve të marrin dhe analizojnë të dhëna jo personale dhe të anonizuara nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve (SMIL).

Certifikata mbi Dënimet Penale - i mundëson qytetarëve të shkarkojnë certifikatën mbi dënimet penale pa pagesë. Qytetarët duhet të kenë nivelin e dytë të verifikimit të identitetit për të pasur qasje në këtë shërbim.



Certifikata mbi dënimet penale

[Raporto problem](#)



Monitorimi i statusit të lëndëve individuale në Gjykatë

[Raporto problem](#)



Platforma e të dhënave "Online"

[Raporto problem](#)

Zgjedhim opcionin
përkatës, i cili lidhet
me Këshillin Gjyqësor
të Kosovës.

 Republika e Kosovës
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

SQ

Mekanizmi për përcjelljen e statusit të lëndëve individuale në Gjykatë


Ju nuk mund të përdorni këtë aplikacion, nuk jeni të përfshirë në asnjë lëndë ligjore.

[Dini](#)


Shembull: Kërkimi tekstual i shërbimit

Shërbimi mund të kërkohet edhe tekstualisht. Për këtë qëllim mund të përdoret fusha 'Kërko shërbimin'.



Portali do të na shfaq të gjitha shërbimet që përmbajnë tekstin e kërkuar:

Zgjedhim opcionin e dëshiruar dhe vazhdojmë me marrjen e shërbimit.



KOSOVA GUIDE